



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT SHKODËR



ANALIZA VJETORE E VITIT 2018

Hyrje.....	fq.3
I. Analiza e treguesve të kriminalitetit sipas çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata e Apelit me pjesëmarrjen tonë.....	fq.5
II. Mbi dinamikën, gjendjen dhe drejtimet e kriminalitetit, sipas çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata e Apelit me pjesëmarrjen tonë.....	fq.6
III. Mbi masat e sigurimit.....	fq.11
IV. Politika e dënimit.....	fq.14
V. Bashkëpunimi me Prokuroritë.....	fq.15
VI. Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë.....	fq.15
VII. Bashkëpunimi me Gjykatën e Apelit Shkodër.....	fq.16
VIII. Marrëdhëniet me median dhe publikun.....	fq.16
IX. Informacion mbi administratën e Prokurorisë.....	fq.16
X. Raporti financiar.....	fq.18
XI. Të dhëna statistikore për secilin Prokuror.....	fq.19
XII. Në vend të mbylljes.....	fq.22

HYRJJE

Prokuroria e Apelit Shkodër, parashtron në këtë raport, funksionimin e saj sipas Kushtetutës dhe ligjeve, në ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si dhe funksione të tjera të ngarkuara me ligje të posaçme.

Viti 2018, ka qenë një vit me praktika të reja për shkak të ndryshimeve, si përsa i përket legjislacionit penal, procedural penal ashtu edhe ligjit organik. Ndryshimet, në kuadrin e Reformës për Drejtësi, kanë prekur edhe vetë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Në ushtrimin e funksioneve të saj, prokurorët e kësaj prokurorie, janë munduar të absorbojnë në mënyrën sa më të shpejtë dhe efikase, ndryshimet e pësuara në legjislacion dhe ndryshimet organike, me qëllim, respektimin e Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjeve në fuqi, respektimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale, etikën, disiplinën në punë, të drejtat e njeriut, duke i vënë vetes përparësi dhe objektiva, duke u angazhuar në kryerjen me sa më efikasitet të funksioneve të saj.

Prokurorët e kësaj prokurorie, në përsosjen e njohurive dhe dijeve të tyre, janë treguar vazhdimisht të angazhuar me pjesëmarrjen e tyre në Programin e Trajnimit Vazhdues, program ky i mundësuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Prokuroria e Apelit Shkodër, e shtrin funksionin e saj në qarkun e Shkodrës, në qarkun e Lezhës dhe në qarkun e Kukësit. Sipas organizimit administrativ të këtyre qarqeve, në të përfshihen Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Duke qenë tre qarqe të mëdha, puna e përballuar në vitin 2018 nga kjo Prokurori, është një punë voluminoze.

Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave ka qenë prioritet në ushtrimin e funksioneve, përgjatë vitit 2018. Rol të posaçëm në këtë drejtim ka pasur dërgimi i çështjeve në gjyq (ankimet) që janë kryer nga Njësia e Përbashkët Hetimore në Prokuroritë e shkallës së parë, që me ndryshimet e reja, janë strukturuar në formën e një Seksioni me emërtimin përkatëse, e cila ka funksionuar.

Vlen të theksohet se seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër Korrupsionit, shpërdorimit të detyrës dhe pastrimit të produkteve të veprave penale ose veprimtarisë kriminale, kanë ushtruar ankime në Gjykatën e Apelit si për masat e sigurimit dhe për gjykimet në themel. Ankimet kanë qenë të arsyetuar drejtë dhe në përputhje me provat që janë administruar gjatë hetimit dhe gjykimet.

Në vitin 2018, ka pasur një rritje të veprave penale kundër korrupsionit, fakt i cili bashkëshoqërohet edhe me një rritje të numrit të çështjeve të ankimuara dhe të përfaqësuara në gjykim në Gjykatën e Apelit me të pandehur të akuzuar e dërguar në gjykim për këtë aktivitet kriminal.

Një rritje të lehtë në drejtim të numrit të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, të cilat janë përfaqësuar në gjykim.

Lufta kundër lëndëve narkotike

Në lidhje me veprat penale, që lidhen me faktet e kundraligjshme që si objekt material kanë lëndët narkotike, të cilat kanë pësuar një rritje të lehtë, në dërgimin dhe përfaqësimin e tyre në gjykim. Kjo shpesh ka të bëjë me faktin se janë shqyrtuar kërkesat për caktimin e masave të sigurimit dhe përgjithësisht këto çështje janë gjykuar edhe në themel si në Shkallën e Parë, edhe në Gjykatën e Apelit mbi ankimin e palëve.

Policia gjyqësore duhet të evidentojë në një shkallë më të gjerë jo vetëm përdoruesit e lëndës narkotike, por në një shkallë më të gjerë të personave që janë të angazhuar me prodhimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Përsa i përket kultivimit të lëndës narkotike, konstatohet se ky tregues ka pësuar rritje.

Prioritete të tjera

Problematik vazhdojnë të mbeten konfliktet e pronësisë, që çojnë në kryerjen e veprave penale të falsifikimit apo të shpërdorimit të detyrës nga funksionarët përkatës.

Vjedhjet vazhdojnë të kenë një peshë të madhe në raportin e përgjithshëm të veprave penale të ndodhura në këto qarqe.

Lufta kundër këtyre veprave penale, nuk mund të zhvillohet e vetme, pasi ndikojnë kryesisht faktorët socialë, në rastin e vjedhjes së pasurisë.

Megjithatë angazhimi nga ana jonë ka qenë maksimal për të përfunduar gjykimin në Gjykatën e Apelit një kohë sa më të shkurtër, duke dënuar me vendimi të formës së prerë, personat përgjegjës.

Të drejtat e njeriut

Në ushtrimin e funksioneve, kemi mbajtur parasysh respektimin e të drejtave të njeriut, qoftë të viktimave, familjarëve të tyre ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve, të paraburgosurve apo të dënuarve. Ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale, sollën për viktimat e veprave penale, të drejta për një pjesëmarrje më të madhe në procedim, gjë e cila është reflektuar në punën e kryer.

Përparësi e veçantë i është dhënë të miturve, qoftë të dëmtuar apo viktima, duke pasur parasysh edhe pjesëmarrjen në gjykim, për veprat penale të kryera nga të miturit dhe ndaj të miturve.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Kemi pasur parasysh mënyrën se si paraqiten ankimet e prokuroreve, vijueshmërinë e tyre, ku një rol të veçantë në përmbushjen e funksioneve tona, e kanë prokurorët e prokurorive përkatëse në argumentimin e ankimeve dhe kundërshtimet në lidhje me vendimet e gjykatave. Në lidhje me institucionet e tjera si Gjykatën, Ministrinë e Drejtësisë Prokurorinë e Përgjithshme etj., bashkëpunimi ka qenë i frytshëm dhe korrekt.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Pasur parasysh lirinë e lëvizjes është tashmë një fakt i njohur që provat apo të dhënat mbi njoftimin e të pandehurve në mungesë që gjenden në shtete të ndryshme. Për këtë shkak ka ekzistuar një bashkëpunim i mirë me shtetet e huaja si në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike të dërguara prej tyre, pranë institucionit tonë.

Rol të veçantë i është kushtuar shqyrtimit të kërkesave për ekstradim, njohje të vendimit të huaj, duke marrë të gjitha masat e duhura për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe parimin e reciprocitetit. Për të gjitha vendimet e Gjykatës, për këto raste është komunikuar me Drejtorinë e Marrdhënieve me Jashtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

I. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË


Volumi i punës në gjykim për vitin 2018

Përgjatë vitit 2018, Prokuroria e Apelit Shkodër, ka punuar duke përfaqësuar akuzën në gjykimi me 1645 çështje.

Në këtë analizë do të evidentojmë edhe problematikën e hasur, rezultatet e arritura dhe krahasimin me vitet e mëparshme.

Volumi i punës për vitin 2018

Çështje penale hemeli	972
Masa sigurimi	308
Administrative penale	365
Gjithsej	1645




Rregjistrimet e çështjeve penale kanë pasur si bazë ankimet e bëra nga Prokurorët si dhe të pandehurit ndaj vendimeve të Gjykatave të Shkallës së Parë, nga institucionet e ndryshme DRSSH apo në çështje të ankimuar kryesisht nga prokurorët.

Rëndisim çështjet e përfaqësuara në gjykim nga subjekte të ndryshëm:

Në 27 çështje administrativo-penale, prokurori nuk ka marrë pjesë pavarësisht se janë të pasqyruara në regjistrat tanë, për shkak të rakordimit me regjistrat e Gjykatës së Apelit Shkodër. Fakti se me ndryshimet ligjore shumë nga këto çështje shqyrtohen në dhomë këshillimi nga ana e Gjykatës.

- **308 masa sigurimi personal me 492 të dyshuar.**
- 93 raste, janë shqyrtuar mbi ankimin e Prokurorit.
- 310 raste janë shqyrtuar mbi ankimin e të dyshuarve (mund të jenë 1 ose disa të dyshuar në një çështje).

Nga këto, cilësojmë se disa prej tyre janë shqyrtuar edhe mbi ankimin e Prokurorit edhe mbi ankimin e të dyshuarve.



Në vitin 2018 rezulton se ka një ulje të numrit të çështjeve me objekt vleftësim ose caktim mase sigurimi personal, në krahasim nga viti 2017, (me 71 çështje më pak).

II.Mbi dinamikën, gjendjen dhe drejtimet e kriminalitetit sipas çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata e Apelit me pjesëmarrjen tonë.

- Çështje penale të përfaqësuar në gjyq në Gjykatën e Apelit Shkodër janë gjithsej **972**, me **1238** të pandehur e **241** të arrestuar.
- *Vepra penale kundër personit, jetës dhe shëndetit*” (Neni 76 – 91 të Kodit Penal) **53** çështje.
- Krahasuar me një vit më parë, numri i çështjeve është rritur me **12** çështje pasi në vitin 2017 numri i këtyre çështjeve ishte **41**.
- *Vepra penale të trafikimit të paligjshëm*” (Neni 114, 141/a, 283, 284 të Kodit Penal) **88** çështje.
- Vendin kryesor e zënë veprat penale të parashikuara nga neni 283 dhe 284 të K.Penal, përkatësisht me **61** çështje (neni 283) dhe **22** çështje (neni 284).
- Ka patur një rritje të këtyre çështjeve në krahasim me vitin 2017 që ka patur përkatësisht 53 çështje (neni 283) dhe 16 çështje (neni 284).
- *“Vepra penale të dhunës në familje”* (Neni 130/a i K.Penal) **73** çështje. Krahasuar me një vit më parë, numri i çështjeve për vitin 2017 ishte **45** çështje, pra me **28** çështje më shumë.
- *“Vepra penale kundër pasurisë dhe sferës ekonomike”* (Neni 134 – 143 të Kodit Penal) **135** çështje, (ku 60 çështje janë për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i K.Penal).

- Krahasuar me një vit më parë, numri i çështjeve të gjykuara për vitin 2017 ishte **131** çështje, pra me **4** çështje më shumë. Ka një ulje të numrit të çështjeve për veprën penale të parashikuar nga neni 137 të K.Penal, e konkretisht vitin e kaluar kanë qënë 78 çështje, ndërsa këtë vit kanë qënë 60 çështje të tilla.
- Veprat penale të parashikuara nga neni 197 dhe 199/a, **61** çështje, krahasuar me një vit më parë, numri i çështjeve për vitin 2017 ishte **39** çështje, pra me 22 çështje më shumë.

“Vepra penale kundër autoritetit shtetëror” (neni)

- **42** çështje, neni 278/2,3,4 dhe 279 i Kodit Penal.
- **36** çështje, neni 248, 258, 259 i Kodit Penal.
- **32** çështje, neni 290 i Kodit Penal.
- **138** çështje neni 291 i K.Penal.
- Gjithsej **248** çështje.

Krahasuar me një vit më parë, numri i çështjeve të gjykuara për vitin 2017 ishte **178** çështje, pra me një rritje prej **70** çështjesh më shumë.

Gjithashtu është rritur numri i çështjeve kryesisht veprat penale të “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, konkretisht me **30** çështje.

Është rritur dhe numri i çështjeve për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” konkretisht **55** çështje nga **34** çështje që ishin në vitin 2017.

Vepra penale të tjera.....**314** çështje

Duke krahasuar dinamikën e veprave penale për vitin 2018, në raport me ato të vitit 2017, konstatohet se:

- Kemi një rritje të veprave penale në fushën e krimit për veprat penale të trafikimit të paligjshëm, e konkretisht neni 283, 284 të K.Penal.
- Kemi një rritje të veprave penale në fushën e drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt 291 të K.Penal.
- Kemi një rritje për vepra penale kundër pasurisë dhe sferës ekonomike.
- Kemi një rritje për veprat penale të shpërdorimit të detyrës.
- Në vitin 2017 janë shqyrtuar **27** çështje për veprën penale të vrasjes; ndërsa për vitin që po analizojmë, rezultojnë **30** çështje penale me këtë objekt, pra një rritje e vogël prej **3** çështjesh nga viti i kaluar.

Lidhur me çështjet administrative-penale, konstatojmë se ka një rritje të gjykimit të çështjeve me këtë objekt, ku vitin e kaluar kanë qenë gjithsej **275**, ndërsa për vitin që analizojmë janë gjykuar **365** çështje, ku edhe në këtë drejtim të rritjes së numrit të çështjeve, vendin kryesor e zënë ankimet e DRSSH Shkodër kundër vendimit të pushimit ose mosfillimit të Prokurorit, pra numri i tyre ka ardhur duke u rritur.

Të ndara sipas rretheve, apelet për çështjet e themelit janë të shpërndara në këtë mënyrë:

❖ **Prokuroria e Rrethit Shkodër:**

Me **640** çështje ose rreth 66 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të shqyrtuara në apel, me **809** të pandehur, nga të cilët **133** të arrestuar.

Nga këto, **418 çështje** kanë ardhur mbi apelin e Prokurorit; janë përkrahur nga Prokurori **141 apele** dhe është hequr dorë në **191** prej tyre pasi shumë prej çështjeve janë për veprat penale 291,137 dhe 145 te Kodit Penal.

Gjykata e Apelit ka pranuar apelin e Prokurorit në **32** raste ndërsa në **86** raste ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, **17** raste lehtësim pozite dhe në 5 raste prishje e vendimit dhe pushim i çështjes, **1** rast kthim për rigjykim.

Në **191** çështje është hequr dorë nga ankimi dhe Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Ndaj këtyre vendimeve janë ushtruar **58 rekurse** në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit.

❖ **Prokuroria e Rrethit Lezhë:**

Me **171** çështje, ose 16 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të shqyrtuara në apel, me **215** të pandehur, nga të cilët **61** të arrestuar.

Nga këto çështje, mbi apelin e Prokurorit janë shqyrtuar **55 çështje**, nga të cilat është hequr dorë në **20** prej tyre dhe është mbrojtur ankimi i Prokurorit në **30** raste.

Gjykata e Apelit ka pranuar apelin e Prokurorit në **12** raste ndërsa në **13** raste ka vendosur sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, **5** raste lehtësim pozite. Në **20** raste është hequr dorë nga ankimi dhe Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Ndaj këtyre vendimeve janë ushtruar **11 rekurse** në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit.

❖ **Prokuroria e Rrethit Kukës:**

Me **470 çështje** ose rreth 7% e totalit, me **95** të pandehur, nga të cilët **23** të arrestuar.

Nga këto çështje, mbi apelin e Prokurorit janë shqyrtuar 26 çështje; është përkrahur apeli në 14 raste. Gjykata e Apelit ka pranuar apelin e Prokurorit në 5 raste, ndërsa në 9 raste ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, heqje dorë 5 raste.

Ndaj këtyre vendimeve janë ushtruar **11** rekurse në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit.

❖ **Prokuroria e Rrethit Pukë:**

Me **68 çështje** ose rreth 7 % të totalit, me **82** të pandehur, nga të cilët **16** të arrestuar. Nga këto çështje, mbi apelin e Prokurorit janë shqyrtuar **38** çështje; është përkrahur apeli në 18 raste, është hequr dorë nga apeli i Prokurorit në **11** raste. Gjykata e Apelit në 3 raste ka pranuar apelin e Prokurorit. Ka lënë në fuqi **15** raste.


Ndaj këtyre vendimeve janë ushtruar **7 rekurse** në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit.

❖ **Prokuroria e Rrethit Tropojë:**

Me **23** çështje, ose rreth 2% të numrit total të çështjeve, me **37** të pandehur, nga të cilët **8** të arrestuar.

Nga këto çështje, mbi apelin e Prokurorit janë shqyrtuar **8** çështje, është përkrahur *ankimi i Prokurorit* në **8 raste**. Gjykata e Apelit ka pranuar apelin e Prokurorit në 3 raste, ndërsa në 4 raste ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në **1** rast lehtësim pozite. Ndaj këtyre vendimeve janë ushtruar **4** rekurse në Gjykatën e Lartë.

Tabela më poshtë pasqyron raportin e numrit të çështjeve të themelit të ndara sipas rretheve:



Rastet e heqjes dorë nga ankimi,

Nga ana e Prokurorëve të Apelit, është hequr dorë nga ankimi në 227 raste. Heqja dorë nga ankimi ka qenë kryesisht lidhur me aplikimin e Nenit 59 të K.Penal, për veprat penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, për veprat penale të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal.

Në lidhje me heqjen dorë nga ankimi është marrë parasysh ankimi i Prokurorëve, të cilët kanë ushtruar ankim lidhur me masën e dënimit kryesisht për veprën penale „*Mashtrime me sigurimet*“ nenin 145 të K.Penal. Prokurorët në ankimin e tyre kanë kundërshtuar aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe në lidhje me deklarinin fajtor të të pandehurve kanë qenë dakort me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Nga ana e Prokurorëve të Apelit është konstatuar se të pandehurit vazhdojnë të shlyejnë detyrimet lidhur me pensionin që kanë përfituar në mënyrë të paligjshme dhe masa e dënimit e dhënë nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor, ka qenë më e rëndë nga ajo që ka kërkuar prokurori në ankimin e tij. Për vitin 2018 vërehet rënie për këto lloj ankimesh për nenin 145 të K.Penal.

Në këto rrethana kur vendimi i Gjykatës, nuk ka cënuar llojin dhe masën e dënimit fajësinë e të pandehurve dhe në kushte kur realizon qëllimin, për të cilin ai është dhënë, duke i vënë të pandehurit në shërbimin e provës, nga ana e prokurorëve të Apelit është parë me vend aplikimi i nenit 59 i K.Penal.

Ankime ndaj vendimeve të Gjykatës së Faktit të ushtruar nga të pandehurit:

Rezulton se mbi ankimin e të pandehurve janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër **626** çështje.

Kërkesat e Prokurorisë, për çështjet e shqyrtuara në Gjykatën e Apelit, kanë qenë si më poshtë:

- Në 5 raste është kërkuar prishje e vendimit dhe kthim i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Faktit. Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën tonë në 2 raste, ndërsa në 3 çështje ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.
- Në 106 raste është kërkuar nga ana jonë prishje e vendimit dhe pushim i çështjes dhe Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën për 105 raste, dhe 1 rast është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Në 73 raste është kërkuar lehtësimi i pozitës së të pandehurit. Gjykata e Apelit ka vendosur sipas kërkesës tonë për 67 raste, ndërsa në 4 raste është vendosur lënie në fuqi e vendimit nga kjo Gjykatë dhe në 2 raste ka vendosur prishje pushim të çështjes.
- Në 350 raste, nga ana jonë është kërkuar lënie në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, nga të cilat Gjykata e Apelit ka vendosur në 242 raste lënie në fuqi të vendimit (ose rreth 69% te rasteve).
- Në 88 raste është vendosur ndryshimi i vendimit (lehtësimi i pozitës së të pandehurve, pra rreth 26% e rasteve). Në 15 raste është vendosur prishje e vendimit dhe pushim i çështjes ose 4% e kërkesave dhe në 5 të tjera është vendosur prishje e vendimit dhe kthim i akteve për rigjykim, ose 1% e tyre.

Në **211** raste nga ana jonë është kërkuar ndryshimi i vendimit (rëndimi i pozitës së të pandehurve), nga të cilat Gjykata e Apelit ka vendosur në **127** raste lënie në fuqi të vendimit.

Në **55** raste ka ndryshuar vendimin, duke rënduar pozitën e të pandehurve, në 23 raste ka vendosur ndryshimin e vendimit (lehtësimin e pozitës së të pandehurve), në 5 raste ka vendosur prishje e pushim të çështjes dhe në 1 rast prishje, kthim i akteve për rigjykim.

Theksojmë se nga 163 apele të Prokurorit të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit për pafajësi ose pushim çështjeje, ku një pjesë të madhe të këtyre e zënë vendimet e ankimura nga prokurorët ndaj vendimeve të Gjykatës së Faktit për të pandehurit të deklaruar të pafajshëm, ka qenë kryesisht për veprat penale të parashikuara nga neni 137 të K.Penal, konkretisht 15 çështje i përkasin kësaj dispozite (ose 9% e tyre). Në 2 raste është vendosur pranimit i apelit të Prokurorit duke u deklaruar fajtor dhe dënuar të pandehurit për kryerjen e kësaj vepre penale. 16 raste kanë qenë për veprën penale të parashikuar nga neni 248, ku Gjykata e Apelit ka deklaruar fajtor në 1 rast; 17 raste kanë qenë për veprën penale të parashikuar nga neni 145, dhe Gjykata e Apelit ka deklaruar fajtor në 3 raste.

Në total, mbi apelin e Prokurorit për pafajësi ose pushim gjykimi, Gjykata e Apelit Shkodër, ka deklaruar fajtor dhe dënuar sipas akuzave, të pandehurit në 23 çështje (ose 53%) të tyre. Në 23 prej tyre është pranuar apeli i Prokurorit, duke vendosur deklarinimin fajtor dhe dënimin e të pandehurve sipas akuzave. Në 12 raste nga këto apele, është vendosur prishje e vendimit dhe pushimi i çështjes (për shkak të përfitimit nga ligji për amnistinë). Lidhur me 1 pafajësi, është vendosur prishje e vendimit dhe kthim i çështjes për rigjykim, në 1 rast prishje, pushim i çështjes pasi personi ka vdekur.

Të ndara sipas rretheve, vendimet me të cilat janë deklaruar fajtorë të pandehurit në Gjykatën e Apelit janë: 15 çështje të Prokurorisë së Rrethit Shkodër, 5 çështje të

Prokurorisë së Rrethit Lezhë, 2 çështje të Prokurorisë së Rrethit Kukës, 1 çështje e Prokurorisë së Rrethit Pukë.

Nga këto, 3 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 145; 1 çështje për 135 të K.Penal, 1 çështje për nenin 199/a/2 të K.Penal, 1 çështje për nenin 291 të K.Penal, 3 çështje për nenin 283 të K.Penal, 1 çështje për nenin 244 të K.Penal, 2 çështje për nenin 130/a/3 , 1 çështje për nenin 174-25 të K.Penal, 1 çështje për nenin 248, 1 çështje për nenin 134; 1 çështje për nenin 278; 1 çështje për nenin 290, 1 çështje për nenin 150, 2 çështje për nenin 137; 1 çështje për nenin 190; 1 çështje për nenin 110/2 dhe 1 çështje për nenin 76.

III. Mbi masat e sigurimit.

Krahas përgatitjes dhe përfaqësimit në gjykim të çështjeve të themelit, një kujdes të veçantë i kemi kushtuar pjesëmarrjes dhe përfundimit të çështjeve me objekt caktimin e masave të sigurimit.

Për periudhën objekt analize, nga Gjykata e Apelit janë shqyrtuar gjithsej dhe përfaqësuar në Gjykatën e Apelit 307 çështje, me 492 të dyshuar, nga të cilat 93 mbi apelin e Prokurorit dhe 310 shqyrtuar mbi apelin e të dyshuarve.

Nga çështjet me objekt shqyrtimin e masave të sigurimit me apel të Prokurorit, Gjykata e Apelit ka vendosur në 44 raste miratim vendimi; në 17 raste rëndim pozite; në 11 raste masë më të butë dhe në 25 raste mospranim ankimi pasi ka hequr dorë Prokurori, për shkak të pabazueshmërisë së ankimit dhe konkretisht disa nga shkaqet për të cilat nga ana jonë është hequr dorë, kanë qënë:

- është shuar masa e sigurimit nga Gjykata e Shkallës së Parë;
- ka përfunduar gjykimi në themel dhe të pandehurit janë dënuar me kusht ose dënim tjetër penal;
- në disa raste është zëvendësuar masa e sigurimit nga Gjykata e Shkallës së Parë por, shumica e heqjes dorë nga ankimi ka qënë për arsye se ndërkohë që gjykohej çështja në Apel, kishte përfunduar afati i masës së sigurimit të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë si dhe rastet kur ishte caktuar masë tjetër sigurimi, dhe nga ana e Prokurorit ishte ankimuar përsëri ky vendim.

Sipas rretheve, apelet ndaj masave të sigurimit ndahen:

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër **227** çështje. Është hequr dorë nga apeli i Prokurorit në **17 prej tyre**, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.


Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër **52** çështje. Është hequr dorë nga apeli i Prokurorit në **3 prej tyre**, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër **19** çështje. Është hequr dorë nga apeli i Prokurorit në **3 prej tyre**, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër **8** çështje. Është hequr dorë nga apeli i Prokurorit në **2 prej tyre**, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër **1** çështje, për të cilën është miratuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë.

Tabela më poshtë pasqyron raportin e numrit të çështjeve të tërmetit të ndara sipas rretheve:



Ndaj këtyre vendimeve janë ushtruar 3 rekurse në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit.

Duke parë të dhënat që rezultojnë nga shqyrtimi në Gjykatën e Apelit të çështjeve me objekt vlerësim e caktim masë sigurimi, mbeten me përhapje të gjerë veprat penale të dhunës në familje (25), vepra penale kundër pronës (25), mbajtja e lëndëve narkotike apo kultivimi i bimëve narkotike (57), mbajtja pa leje e armëve luftarake (21); ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve (25); shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (10); shpërdorim detyrë (14); drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt (8), dhe vjedhje me dhunë (8).

◆ **Të dhëna mbi ekzekutimet e vendimeve penale.**

Gjatë vitit 2018, janë lëshuar gjithsej 104 urdhëra-ekzekutimi, të cilat kanë qenë urdhëra ekzekutimi për lirimin e menjëhershëm, për arrestime kur është rënduar masa e sigurimit, si edhe për ekstradimet duke urdhëruar Prokuroritë përkatëse për vënien në ekzekutim të këtyre urdhërave etj.

Cilësoj se urdhërat e ekzekutimit janë nxjerrë në kohë dhe brenda afateve ligjore nga ana e Prokurorëve të Apelit.

Më poshtë janë të pasqyruara në tabelë, urdhërat e ekzekutimit, të ndara sipas Prokurorëve dhe llojit të çështjes (masa sigurimi, çështje themeli dhe çështje administrative).

Prokurorët/ Lloji i çështjes	Masa sigurimi	Çështje Themeli	Çështje Admin.	Total
Elvin Gokaj	38	7	2	47
Brahim Dragjoshi	30	4	1	35
Arben Dollapaj	14	3	1	18
Besa Nikëhasani	2	2	0	4
Total	84	16	4	104

Në Gjykatën e Apelit Shkodër, janë shqyrtuar **9 çështje** me objekt “Miratim ekstradimi”, nga të cilat **6 janë miratuar**, duke u lejuar ekstradimi dhe **3 prej tyre** janë ndryshuar (në 2 raste është shuar masa e sugurimit, dhe në 1 rast është ndryshuar masa nga “arrest në shtëpi”, në “arrest në burg”).

Janë shqyrtuar **3 çështje** me objekt “Njohje e vendimit të huaj”, për të cilat Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur miratimin e kërkesës së Prokurorit.

IV. POLITIKA E DËNIMIT:

Për veprat penale të cilat karakterizohen, si nga numri i madh i regjistrimit të procedimeve penale për to, ashtu edhe nga specifika që paraqesin, është ndjekur në përgjithësi kjo politikë duke mbështetur në përgjithësi qëndrimin tonë ligjor, ku është bërë kujdes i veçantë

nga ana jonë, zbatimi i një politike të drejtë dënimi, në funksion të një lufte efektive ndaj kriminalitetit aktual si dhe parandalimit të tij.

Nëpërmjet kërkesave tona objektive dhe të argumentuara, jemi perpjekur për t'i imponuar kështu Gjykatës së Apelit të japë lloje dhe masa dënimi, në përputhje me kriteret ligjore dhe gjëndjen e kriminalitetit në rrethet dhe zonat, ku ai respektivisht është shfaqur.

Në funksion të idesë që faji të mos shpëtojë pa u dënuar dhe pafajësia të mos vuajë padrejtësisht, jemi përpjekur dhe vazhdojmë të përpiqemi të procedojmë duke dhënë goditje në drejtim të forcimit të politikës së dënimit, sidomos ndaj veprave penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore si dhe ndaj atyre me përhapje dhe frekuencë të lartë. Vlen të theksohet se për çështjet që kanë ardhur me vendim pafajsie nga Gjykatat e shkallës së Parë, kemi hasur vështirësi për zbatimin e nenit 427 të K.Pr.Penale, për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja. Pasi, me ndryshimet ligjore Gjykata e Apelit, nuk mund të deklarojë fajtor një të pandehur, i cili është deklaruar i pafajshëm në Gjykatën e shkallës së Parë me të njejtat prova, që janë shqyrtuar gjatë gjykimit në shkallë të parë. Megjithatë vlen të theksohet se Gjykata e Apelit Shkodër ka proceduar me dy praktika të ndryshme, në disa raste ka pranuar kërkesën e Prokurorit për marrje të provave të reja duke deklaruar fajtor të pandehurit, të cilët gjatë gjykimit në shkallë të parë janë deklaruar të pafajshëm. Dhe, në raste të tjera ka lënë në fuqi vendimin e pafajsisë me arsyetimin se nuk ka prova të reja.

V. BASHKËPUNIMI ME PROKURORITË E TJERA

Marrëdhëniet ndërmjet Prokurorive janë domosdoshmërisht të nevojshme pasi i shërbejnë më së miri zgjidhjes së problematikës së hasur në punën e përditshme, duke kërkuar zgjidhje ligjrisht dhe bashkëpunimit me prokuroritë e rretheve të tjera gjyqësore në koordinimin e hetimeve dhe dhënien e informacioneve që mund të nevojiten.

Përsa i përket Prokurorive të rretheve Shkodër, Lezhë, Kukës, Pukë, Tropojë kemi pasur kontakte të herëpashershme dhe kjo i ka shërbyer punës në lidhje me kualifikimin, vendimmarrjen, për të dhënë një zgjidhje sa më të drejtë dhe ligjore për rastet.

Me kujdes të veçantë janë ndjekur mënyra e përfundimit të çështjeve, të cilat janë ankimuar si nga të pandehurit ashtu edhe nga ana Prokurorëve.

Për çdo vendim të Gjykatës së Apelit, menjëherë dhe zyrtarisht nga ana jonë, i është dërguar shkurtimi i vendimit Prokurorisë përkatëse.

Nga ana e Prokurorëve janë dërguar në kohë kopje të ankimeve të bëra, duke bërë të mundur që nga ana e Prokurorëve të Apelit të informohemi në kohë lidhur me qëndrimin e tyre ndaj vendimeve të Gjykatës së Faktit. Konstatohet se gjatë vitit 2018 nuk ka pasur ankime të shumta të bëra nga Prokurorët për rritje të masës së dënimit, në krahasim me vitin 2017 ku megjithëse diferenca mes kërkesës së Prokurorit dhe vendimit të Gjykatës ka qenë e vogël, një gjë e tillë shtonte artificialisht volumin e punës.

Gjithashtu është evidentuar shpeshherë edhe nga Gjykata e Apelit, mungesa e informacionit që kanë Prokurorët për të informuar çdo dy muaj gjykatën për zbatimin e vendimit të arrestit neni 246/6 i K.P.Penal, veprim i cili është bërë shkak për kërkesat e të dyshuarve lidhur me zëvendësimin e këtyre masave.

Në fashikujt gjyqësorë duhen të administrohen edhe provat e marra gjatë seancave të vlerësimit të masës pasi konsiderohen si të marra në gjykim, por edhe për shkak të evidentimit të gjyqtarëve që kanë dhënë këto vendime, këto fashikuj është e domosdoshme t'i bashkangjiten fashikullit të gjykimit.

Duhet bërë kujdes në paraqitjen e ankimit konform rregullave të përcaktuara në ligj pasi Gjykata e Apelit Shkodër në disa raste ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak se nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit (neni 420, gërma "c", të K.Pr.P).

VI. BASHKËPUNIMI ME MINISTRINË E DREJTËSISË

Një bashkëpunim për t'u vlerësuar është edhe me Ministrinë e Drejtësisë si në rastin e informimit të herëpashershëm të ekspertëve që vihen në dispozicion të organeve të drejtësisë, në përcjelljen e letërporosive, në krijimin e kushteve të favorshme për bashkëpunim me institucionet e vuajtjes së dënimit apo paraburgimit etj.

VII. BASHKËPUNIMI ME GJYKATËN E APELIT SHKODËR

Bashkëpunimi me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, ka qenë i vlefshëm. Gjyqtarët kanë qënë të gatshëm dhe të disponueshëm në çdo kohë për gjykimet në themel, kërkesa që kanë të bëjnë me vleftësimin e masave të sigurimit, për lejimin e veprimeve të përgjimit, etj.

Gjykata ka ruajtur solemnitetin e saj si arbitër mes palëve të barabarta dhe nga ana jonë është respektuar pozicioni i saj. Për zgjidhjet që janë vlerësuar në kundërshtim me kërkesat e prokurorëve është ndjekur rregullisht rruga ligjore, pra janë ushtruar rekurse.

VIII. MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Në lidhje me publikun është për t'u theksuar fakti se nga ana e prokurorëve por edhe e drejtuesit, është mundësuar vazhdimisht pritja me korrektësi e ankesave, shqetësimeve të qytetarëve duke u munduar t'u jepet një zgjidhje sa më e shpejtë, e drejtë dhe ligjore. Natyrisht që parashtrimi i problemeve nga ana e publikut nuk është kufizuar vetëm në një ditë të veçantë pasi stafi ynë gjatë gjithë kohës është në ushtrim të detyrës së tij.

MARRËDHËNIET ME MEDIAN

Brenda kuadrit të respektim edhe të të drejtave të qytetarëve për informim, jemi munduar të ruajmë një marrëdhënie sa më korrekte me median, ku çdo informacion, lidhur me

publikimin e vendimeve të Gjykatës i kemi vënë në dispozicion për faktin se vendimet nuk përbëjnë sekrete hetimore. Jemi munduar pa çënuar prezumimin e pafajësisë, të drejtën private si dhe në mbrojtje të të drejtave të të miturve.

Një çështje problematike në raportet me mediat, mbetet pasqyrimi i të dhënave dhe informacioneve të fazës së hetimeve paraprake, të marra nga burime të ndryshme nga prokuroria. Shpesh çënohet parimi se çdo person është i pafajshëm derisa të shprehet gjykata me një vendim fajësie të formës së prerë.

IX. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË.

ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME STRUKTURA ORGANIZATIVE

Në fund të vitit 2018, dhe fillimin e vitit 2019 stafi i kësaj prokurorie, përbëhet nga 6 punonjës.

Numri i prokurorëve është 2, nga të cilët 2 meshkuj.

K/Sekretare 1, Sekretare pranë Prokurorëve 2, nga të cilat 3 femra.

Shofer 1.

Puna e prokurorëve është ushtruar nën drejtimin e drejtuesit të kësaj prokurorie i cili ndihmohet aktualisht vetëm nga një 1 prokuror.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.2 datë 19.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Udhëzimit nr. 3 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, nga drejtuesi i kësaj prokurorie, është urdhëruar ndarja e çështjes me trupa gjykues, referuar ngarkesës së barabartë të çështjeve të veprave penale.

Tabela organike numerike e Prokurorisë, që ushtron funksionin aktualisht:

Drejtues	1
Prokuror	1
K/sekretare	1
Sekretare	2
Shofer	1
Gjithsej	6

Në përputhje me ngarkesën, mendojmë se në Prokurorinë e Apelit Shkodër numri i Prokurorëve është i pamjaftueshëm për të përballuar volumin e punës të pasqyruar në këtë

raport, pasi në organikë është përcaktuar që në Prokurorinë e Apelit Shkodër do të ushtrojnë funksionin e tyre 4 prokurorë.

Ushtrimi i detyrës nga stafi i mësipërm bëhet në godinën e re pranë Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Shkodër. Kushtet, në të cilat ushtron funksionet i gjithë stafi i kësaj Prokurorie, specifikisht akomodimi në zyra të mira, është një faktor që ndikon drejtpërdrejt në punën e përditshme.

Me gjithë ngarkesën në punën e përditshme, janë ruajtur marrëdhënie të vazhdueshme me Shkollën e Magjistraturës. Kjo e fundit ka dërguar programet e trajnimeve, të cilat janë plotësuar nga prokurorët. Këta të fundit kanë marrë pjesë në kurset e trajnimit të zgjedhura prej tyre e të organizuara në Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu prokurorët kanë marrë pjesë në aktivitete të tjera si sesione trajnimi, tryeza të rrumbullakëta, konferenca etj.

Në Prokurorinë e Apelit Shkodër është bërë tashmë i mundur aksesimi në internet, një ndërmarrje që i ndihmon si prokurorët ashtu edhe stafin në azhornimin me legjislacionin, studimin dhe mbajtjen në koherencë me praktikën gjyqësore apo marrjen e informacioneve nga institucione që i kanë bërë të dhënat e tyre të aksesueshme nëpërmjet internetit.

X. RAPORTI FINANCIAR

Në Prokurorinë e Apelit Shkodër gjatë vitit 2018 për ushtrimin e veprimtarisë Ekonomike-financiare janë çelur fondet:

Buxheti total për vitin **2018** ka qënë në masën **12.507.900** lekë, ndërsa realizimi i këtij buxheti ka qënë në masën **12.431.471**, pra rreth **99%**.

Të ndarë në zëra paraqitet si më poshtë:

Në zërin **600**, fondi ka qënë **10.144.400** lekë, ndërsa realizimi ka qënë në masën **10.128.511**.

Në zërin **601** fondi ka qënë **1.400.000** lekë, ndërsa realizimi ka qënë në masën **1.373.165**.

Në zërin **602** ka qënë **963.500** lekë ndërsa realizimi ka qënë në masën **929.795**.

Janë shpenzuar në total **12.431.471** lekë.

Krahasuar me vitin 2017, buxheti total ka qënë në masën 13.055.320, ndërsa realizimi ka qënë në masën 12.345.828.

Niveli i shpenzimeve të pasqyruara më sipër janë rakorduar me degën e thesarit Shkodër, çdo muaj, sipas situacionit analitik, të mbajtur sipas standartit të përgatitur nga Ministria e Financave, situacion i cili është përcjellë çdo muaj në Prokurorinë e Përgjithshme.

Sqarojmë se këtë vit fondi në zërin **600** dhe **601**, në ndryshim nga viti i kaluar ka ardhur në ulje pasi nga Prokuroria e Apelit Shkodër është larguar një Prokuror.

Regjistrat në Prokurorinë e Apelit Shkodër, mbahen në mënyrë të atillë që të rakordojmë me regjistrat që disponon Gjykata e Apelit Shkodër. Këto regjistra janë të ndarë në:

- 1-Regjistër për çështjet e themelit.
- 2-Regjistër për vleftësim dhe caktim masa sigurimi.
- 3-Regjistër për çështjet administrative.

Në bazë të këtyre regjistrave plotësohen çdo muaj të dhënat statistikore, të cilat përcillen në rrugë elektronike në Prokurorinë të Përgjithshme, një herë në muaj (për çështjet e themelit), si dhe çdo 3 muaj për të gjitha çështjet në total.

Sa i takon sigurisë së institucionit, Prokuroria e Apelit Shkodër ushtron veprimtarinë e saj në godinën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e për rrjedhojë dhe tenderi i rojeve zhvillohet nga Prokuroria e Rrethit Shkodër.

XI. TË DHËNA STATISTIKORE PËR SECILIN PROKUROR

Prokurori Elvin GOKAJ (Drejtuesi i Prokurorisë)

Në muajin korrik të vitit 2016 është emëruar me detyrë Drejtues pranë Prokurorisë së Apelit Shkodër. Marrëdhëniet me prokurorët dhe stafin administrativ kanë qenë korrekte. Është pasur kujdes si në kontrollin e punës së prokurorëve gjatë përfaqësimit të akuzës në Gjykatë ashtu edhe të prezencës së tyre dhe të administratës gjatë orarit të punës. Për rastet kur janë vërejtur mangësira, është marrë kontakt me personin konkret duke dëgjuar arsyet e sjelljes së tij dhe sipas rastit është këshilluar. Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, është nxjerrë çdo muaj urdhëri i gatishmërisë për prokurorët lidhur me përfaqësimin e çështjeve në gjykim me objekt vleftësim dhe caktim masa sigurimi si dhe kërkesa të tjera në fazën e hetimeve paraprake.

Nga ana drejtuesit është treguar kujdes në shpërndarjen e çështjeve për çdo prokuror, duke u mbajtur parasysh një shpërndarje sa më e drejtë e volumit të punës, sipas objektit të veprave penale që përfshihen në këto çështje. Është patur vazhdimisht parasysh ngarkesa e secilit prej tyre. Ndarja e çështjeve është bërë kryesisht me short me trupa gjykues për të shmangur përplasjen e orareve të gjykimit dhe për moszvarritjen e gjykimeve. Për çdo muaj është përpiluar procesverbali i shortit duke ia bërë prezent prokurorëve.

Gjithashtu ka ushtruar 2 rekorse (një për nenin 137/1 dhe nenin 84 e 278/2) kundër vendimit të Gjykatës se Apelit edhe në ato raste kur nga ana e Prokurorit të çështjes është shprehur mendimi për mosushttrim rekursi. Nga ana e drejtuesit të Prokurorisë është marrë parasysh pavarësia e Prokurorit në gjykim duke mos ndërhyrë në asnjë çështje për zgjidhjen e saj.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë në zbatim të detyrimeve ligjore dhe udhëzimit nr. 3 datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm janë përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër këto çështje penale:

- Çështje themeli..... 351 çështje
- Vleftësim dhe caktim mase sigurimi..... 144 çështje
- Çështje të tjera..... 128 çështje
- **Gjithsej..... 623 çështje**

Prokurori Elvin GOKAJ ka hequr dorë në 44 çështje prej të cilave:

Më poshtë paraqitet tabela për heqje dorë nga ankimi i Prokurorit sipas neneve përkatëse:

Neni	291	178	145	180	177	137/1	189	146	290	199	188	179	183	134
Raste	15	2	9	3	1	5	1	1	1	1	1	1	1	2

Ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, gjithsej **78 rekurse**, nga të cilat **76 rekurse** për çështje themeli dhe **2 rekurse** për çështje administrative-penale.

Në asnjë rast nuk është hequr dorë nga ankimi kur çështja ka ardhur për gjykim në Gjykatën e Apelit me vendim pafajsie. Rastet e heqjes dorë janë për shkak të masave të dënimit si dhe aplikimin i nenit 59, 63 i K.Penal

Prokurore Besa Nikëhasani (Prokurore Apeli)

Ka ushtruar funksionin e saj në Prokurorinë e Apelit Shkodër që nga viti 2004 deri në shkurt të vitit 2018. Për vitin që po analizojmë, Prokurorja Besa Nikëhasani është treguar e gatshme në kryerjen e konsultave me prokurorët dhe në diskutimin e çështjeve problematike. Marrëdhëniet me prokurorët e tjerë, stafin dhe drejtuesit e institucioneve të tjera ka qenë gjithmonë korrekte.

Nga ana prokurores Besa Nikëhasani janë përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër këto çështje penale:

- Çështje themeli..... 51 çështje
- Vleftësim dhe caktim masë sigurimi..... 11 çështje
- Çështje të tjera..... 19 çështje
- **Gjithsej 81 çështje**

Prokurore Besa Nikëhasani ka hequr dorë në **11** raste çështje prej te cilave:

Më poshtë paraqitet tebela për heqje dorë nga ankimi i Prokurorit sipas neneve përkatëse:

Neni	145	291	178	137
Raste	2	6	1	2

Ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, **4** rekurse, nga të cilat 2 rekurse për çështje themeli dhe 2 rekurse për masa sigurimi. ***Aktualisht Besa Nikëhasani nuk ushtron më funksionet e Prokurorit.***

Prokurori Brahim Dragjoshi (Prokuror Apeli)

Ushtron funksionin e Prokurorit në Prokurorine e Apelit Shkodër. Puna e tij ka qenë voluminoze pasi ka konsistuar në përfaqësimin e çështjeve të themelit në Gjykatë, ashtu edhe në masat e sigurimit. Është treguar i gatshëm në kryerjen e detyrës, duke mos u bërë shkas për shtyrjen e gjyqeve për mungesën e tij. Gjithashtu ka nxjerrë në kohë udhërat e ekzekutimit të menjëhershëm duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në marrëdhëniet me prokurorët e tjerë, stafin administrativ, me drejtuesin e institucionit ka qenë gjithmonë korrekte.

Nga ana e Prokurorit Brahim Dragjoshi, janë përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër këto çështje penale:

- Çështje themeli.....	381 çështje
- Vleftësim dhe caktim mase sigurimi.....	106 çështje
- Çështje të tjera.....	128 çështje
Gjithsej.....	615 çështje

Prokurori Brahim Dragjoshi ka hequr dorë në 83 çështje, prej të cilave:

Më poshtë paraqitet tabela për heqje dorë nga ankimi i Prokurorit sipas neneve përkatëse:

Neni	180	187	137	170	291	278	242	189	134	145	130	305	281	248	283	144	186
Raste	1	1	11	1	24	4	2	5	5	9	5	2	1	3	3	1	3

199	237	183	110	121/a	324	89	297	78	143	279	290	204-25	287	190	84
4	1	1	2	1	1	1	2	1	3	1	1	1	1	1	1

- **Ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, 15 rekurse, nga të cilat 13 rekurse për çështje themeli, 1 rekurs për masa sigurimi dhe 1 rekurs për çështje administrative-penale.**

Prokurori Arben Dollapaj (Prokuror Apeli)

Ka ushtruar funksionin e Prokurorit në Prokurorinë e Apelit Shkodër që nga muaji maj 2016 deri në dhjetor 2018. Gjatë kësaj periudhe ka konsistuar në përfaqësimin e çështjeve të themelit në Gjykatë ashtu edhe në masat e sigurimit. Për vitin që raportojmë, për një periudhë 2-mujore (mars-prill), ka qënë me raport mjekësor. Është treguar i gatshëm në kryerjen e detyrës, duke mos u bërë shkas për shtyrjen e gjyqeve për mungesën e tij. Gjithashtu ka nxjerrë në kohë urdhërat e ekzekutimit të menjëhershëm duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Marrëdhëniet me prokurorët e tjerë, stafin administrativ, me drejtuesin e institucionit kanë qënë gjithmonë korrekte.

Nga ana e Prokurorit Arben Dollapaj, janë përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër këto çështje penale:

- Çështje themeli..... 189 çështje
- Vleftësim dhe caktim mase sigurimi..... 47 çështje
- Çështje të tjera..... 63 çështje
- **Gjithsej..... 299 çështje**

-

- **Prokurori Arben Dollapaj ka hequr dorë në 68 çështje, prej të cilave:**

- **Më poshtë paraqitet tabela për heqje dore nga ankimi i Prokurorit sipas neneve përkatëse:**

Neni	283	137	291	284	178	145	186	248	242	290	134
Raste	4	11	14	3	1	9	3	1	2	2	1

189	130	236	141	199	190	298	289	265	275	84
1	4	3	1	1	2	1	1	1	1	1

Prokurori Arben Dollapaj, aktualisht ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

XII. NË VEND TË MBYLLJES

Mbajmë parasysh në përgjithësi luftën ndaj veprave penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave, narkotikëve dhe specifikisht edhe veprat penale më të evidentuara në të gjitha qarqet ku kjo prokurori shtrin funksionin si ato në sferën ekonomike, edhe kundër pasurisë, krimet kundër jetës etj. Sidiqoftë, lufta ndaj kriminalitetit nuk kryhet vetëm por në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e të gjithë hallkave dhe strukturave të shtetit si dhe të vetë shtetasve. Kjo vjen si pasojë e njohjes me problematikat e një viti të kaluar, në çështjet në gjykim.

Kjo Prokurori është angazhuar vit pas viti për rritjen e rezultateve në punën e saj dhe ka treguar se përkushtimi i gjithë stafit ka qenë serioz. Treguesit e mësipërm pasqyrojnë rezultatet në rritje.

Megjithatë angazhimi vazhdon, duke ushtruar çdo pjestar i kësaj prokurorie, detyrën e tij në përputhje me Kushtetutën, ligjin, në respektim të të drejtave të njeriut. Një rol të rëndësishëm në ushtrimin e ndjekjes penale e kanë oficerët e policisë gjyqësore kryesisht ata të Drejtorisë dhe Komisariateve, ngelet një mision për t'u vazhduar që të përmbushet bashkëpunimi sa më i frytshëm me oficerët nga ana e Prokurorive të Rretheve.

Objektivat dhe prioritetet që kërkohet të arrihen nga ana jonë kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten gjykimi i shpejtë, efektiv, në garantim të plotë të të drejtave të pjesëmarrësve gjatë procedimit penal, marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet e tjera; zhvillimi i një raporti të ndërsjellë, më të ngushtë mes prokurorisë; marrëdhëniet me autoritetet e drejtësisë së shteteve të tjera (gjë që natyrisht kërkon një ndihmë nga hallka hierarkike më e lartë); përmirësimi i cilësisë së gjykimit, vendimmarrjes dhe rritjes profesionale të mtejshme të prokurorëve dhe të stafit të saj. Duke njohur aftësitë edhe mangësitë tona, duke u përpjekur të përmirësohemi në punën tonë, në respektim të kuadrit ligjor, në bashkëpunim me institucionet e tjera ligjzbatuese, angazhohemi, për ushtrimin e funksionit tonë në mënyrë që gjykimi të jetë sa më i shpejtë dhe efektiv, duke çuar drejt zgjidhjeve të drejta të çështjeve, në respektim të të drejtave të gjithsecilit.

DREJTUESI I PROKURORISË

ELVIN GOKAJ

Shënim: Të dhënat statistikore janë nxjerrë nga regjistrat që disponon Prokuroria e Apelit Shkodër, dhe në bazë të evidencave që përcillen nga Sekretaria, çdo muaj pranë Prokurorisë së Përgjithshme.